

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e çështjen penale me Nr. akti 4/5/13/47/88, datë 17.12.2020, në ngarkim të të pandehurit: **Laert Haxhiu**, i akuzuar për kryerjen e veprave penale të “*Vrasjes me paramendim kryer për hakmarrje*”, mbetur në tentativë, në dëm të shtetasit Xhulio Shkurti, kryer në bashkëpunim të veçantë atë grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 78/2 e 22, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal; “*Vrasja në rrethana të tjera cilësuese*” ndaj dy ose më shumë personave, në dëm të viktimave Zamir Latifi, Jurgen Hoxha, kryer në bashkëpunim të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 79/dh, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, “*Vrasja në rrethana të tjera cilësuese*” ndaj dy ose më shumë personave, e mbetur në tentative, në dëm të shtetasve Bujar Turku dhe Marius Xhepexhiu, kryer në bashkëpunim të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 79/dh, në lidhje me nenet 22 - 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal; “*Mbajtje pa leje të armëve luftarake*”, “*Prishja e qetësisë publike*” kryer në bashkëpunim në veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 278/1, 274, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal; “*Grup i strukturuar kriminal*” në formën e krijimit, organizimit dhe drejtimit, parashikuar nga neni 333/a/1 i Kodit Penal.
2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët: Erjon Çela, Atalanta Zeqiraj dhe Flojera Davidhi bazuar në nenet 22, 28/4, 55, 78/2, 79/dh, 333/a/1, 334/1/2 të **K.Penal**, nenet 4/2, 387, 328/1 shkronja “ç”, 390, 393 dhe 485 të **K.Pr.Penale** me vendimin Nr. 26, datë 24.04.2024 vendosi:
 1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Laert Haxhiu** për kryerjen e veprës penale “*Vrasja me paramendim*” për hakmarrje, mbetur në tentativë ndaj viktimës Xhulio Shkurti, kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 78 paragrafi i dytë, në lidhje me nenet 22 dhe 28 pika 4 të K.Penal si dhe në bazë të nenit 334 pika 2 të Kodit Penal, dënimin e tij me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim.
 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Laert Haxhiu** për kryerjen e veprës penale “*Vrasja në rrethana të tjera cilësuese*” ndaj dy ose më shumë personave, ndaj viktimave Zamir Latifi,

Jurgen Hoxha, Bujar Turku dhe Marjus Xhepexhiu, kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 79/dh, në lidhje me nenin 28 pika 4 të K.Penal si dhe në bazë të nenit 334 pika 2 të Kodit Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Laert Haxhiu** për kryerjen e veprës penale “*Mbajtja pa lejë dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”, kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 278 paragrafi i parë, në lidhje me nenin 28 pika 4 të K.Penal si dhe në bazë të nenit 334 pika 1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim.
4. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Laert Haxhiu** për kryerjen e veprës penale “*Grup i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a paragrafi i parë i K.Penal, dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim.
5. Pushimin e akuzës penale në ngarkim të të pandehurit **Laert Haxhiu** për veprën penale “*Prishja e qetësisë publike*”, kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 274, në lidhje me nenin 28 pika 4 të K.Penal, pasi ndjekja penale nuk duhet të fillonte.
6. Në aplikim të nenit 55 paragrafi i parë i K.Penal, bashkimin e dënimeve dhe dënimin përfundimisht të të pandehurit **Laert Haxhiu** me një dënim të vetëm, atë me burgim të përjetshëm.
7. Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Laert Haxhiu** të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së lartë.
8. Shpenzimet procedurale gjatë fazës së hetimit i lihen në ngarkim të pandehurit **Laert Haxhiu** në mënyrë solidare bashkë me të dënuarit **Orgest Bilbili** dhe **Anterio Kaloshi**, ndërsa shpenzimet e gjyqimit i lihen në ngarkim të pandehurit **Laert Haxhiu**.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga palët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

U shpall në Tiranë, sot më datën 24.04.2024.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

